

341.24-027.09

Bashkim SELMANI PhD¹

**ROLI DHE POZITA E JURIDIKE E KONTRATAVE
KONSENSUALENË SISTEMET E SË DREJTËS BASHKËKOHORE
NDËRKOMBËTARE DHE KONSUMATORIT**

**УЛОГАТА И ПРАВНАТА ПОЗИЦИЈА НА
КОНЗЕНСУАЛНИТЕ ДОГОВОРИ ВО СИСТЕМИТЕ НА
СОВРЕМЕНОТО МЕЃУНАРОДНОТО ПРАВО И
ПОТРОШУВАЧОТ**

**THE ROLE AND POSITION OF LEGAL CONSENSUAL
CONTRACTS IN THE SYSTEM OF CONTEMPORARY
INTERNATIONAL LAW AND THE CONSUMER**

Abstract

Contractual obligations with international character are facing with many challenges which we will treat in this scientific paper in international law standpoint of private entities and obstacles that are presented in the legislation between countries. This scientific paper is aimed for investigation of ascertain if it may create concerns in the legal national gaps or eventual problems as a result of differences in contract international law of the member countries of the European Union and non-member countries. If there are problems and difficulties legal or real concerns in this area, should the functioning of the internal trade and the legal system, the interpreter of their difficult contraction between the parties when entering into the contract an international or interstate right obligations case of contract, interpretation, rights and obligations or other legal issues related to the implementation of international private law and private EU law. Challenges of private international law should be seen

¹ Profesor Universitar, i lëndës “E drejta Romake –Ius Romanus” në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës –Tetovë, 2015. Lecturer at the Faculty of Law, State University of Tetova.

in the area of harmonization of contract law that can come to inexistence in European level and wider as a barrier which restricts fundamental and legal rights of private citizens and the rights of the usefulness the individual. That consists of three parts as; personal relations between citizens, property relations with persons of authority as titular property and procedural law governing the protection of personal rights and the subjective character property in practice face more difficulties in private international law. Key words: obligations, contracts, common international trade, European Union Law, consensual contracts, est.

1. Kuptimi i kontratave konsensuale dhe roli konsensusit mes palëve

Kontratat konsensuale janë kontrata të cilat lidhen me konsensus midis palëve me akordimin e vullnetit të lirë dhe real, të vullnetit të brendshëm dhe ati të manifestuar. Kontratat konsensuale janë e arritura më e madhe e të drejtës detyrimore klasike, sepse kontratat e tilla u bënë instrument juridik shumë efikas për zhvillimin e ekonomisë së tregut, për qarkullimin e mallit dhe parasë në bazë të kriterit të ofertës dhe kërkesës në treg. Një ndër kontratat që mundëson qarkullimin e mallit të parasë në mënyrë juridike është *emciovendicio*-kontrata shitblerjes është kontratë konsensuale, është kontratë e dyanshme e barabartë, sepse juristët romakë thoshin: *Sinallagma*-efektin juridik, të *për atë që ke marrë*–kundërvlerën. Kjo kontratë në bazë të kësaj quhet *Kontrata sinallagmatike-Kontrata e dyanshme e barabartë*, sepse në të njëjtën kohë si për njërën palë ashtu edhe për tjetrën lindin të drejta dhe detyrime reciproke. Subjektet e kësaj kontrate janë: Shitësi me aftësi të plotë obligatore juridike dhe Blerësi me aftësi të plotë obligatore juridike. Objekt të kontratës janë: Malli *Merks* dhe Çmimi *Precium*. Malli *Merks* duhet të jetë send i lejueshëm për qarkullim ekonomik-juridik, i gatshëm për përvetësim privat, në pronësi të shitësit, sepse nëpërmjet kësaj kontrate blerësi konstituon të drejtën pronësore mbi mallin. Askush nuk mund t'i kaloj tjetrit më shumë të drejta se sa i ka vet. Malli të jetë në pronësi të shitësit, malli të jetëposibles, sendi të jetë i caktuar, saktë që mund të vlerësohet me para, mos të ketë malli të meta fizike-juridike. *Të meta fizike* kuptojmë, që të mos ketë mangësi fizike, që do të pamundësoj për palën tjetër realizimin e qëllimit të lidhjes së kontratës, për shembull: kali për vrapim ka sëmundje të çmendurisë të kohëpaskohshme, ai nuk i shërben qëllimit të lidhjes së kontratës. Të meta juridike, kali i shitur nuk është në pronë të shitësit,

por është i vjedhur nga ai. Çmimi *Preciumisi* pjesë e kontratës së objektit të shitblerjes. Çmimi duhet të jetë i vërtetë jofiktiv *jo sa për sy e faqe*, jo për ta sjell personin e tretë në lajthitje, për shembull: nxirret fjala në opinion se personi A dhe B kanë lidhur kontratën e shitblerjes ku mall është toka për ndërtim, e shkallës së parë dhe me minimum prej 10-mijë as m2. Ndërsa në realitet çmimi i tokës në realitet në treg është 2-mijë ass... Ndërmjet është qëllimi i nxitjes së fqinjit të parë që të futet në lojë dhe në konkurrencë jolojale për blerjen e asaj parcele ndërtimore, prandaj ligjvënësi romak thotë: të jetë i vërtetë çmimi, të jetë e saktë shumta e caktuar e parave.²

Të drejtat e shitësit – ka të drejtë që të kërkojë nga blerësi pagimin të kontraktuar menjëherë në momentin e lidhjes së kontratës, nëse kjo kontratë është e llojit të kontratës me efekt të menjëhershëm, momental ku kontrata në të njëjtën kohë lidhet, përmbushen detyrimet dhe realizohen të drejtat mes palëve reciproke dhe shuhen ose të kalojë nga blerësi që përherë t’i paguajë këste për çmimin e paguar *pro-pate-rata*. Në detyrimet e përhershme, palët merren vesh që *pro-pate-rata* të realizojë çmimin e kontraktuar, t’i realizojë shitësit. Cili është detyrimi i shitësit? Detyrimi i shitësit në këtë rast është që tërë kohën e caktuar t’ia dorëzojë blerësit mallin e kontraktuar në sasi, lloj dhe cilësi të rregullta juridike. Malli dorëzohet në vendin e kontraktuar edhe atë në momentin e lidhjes së kontratës ose në pjesë të ndara, nëse është send i ndashëm, përndryshe mos përmbushja e rregullt e këtij detyrimi do të shkaktoj *morra-debitores* vonesën e debitorit dhe ai mbanë rrezikun për zhdëmtim *Reparacio-Dom*. Detyrimi i shitësit është që mallin ta dorëzojë në gjendje të rregullt, e drejta e blerësit është që të kërkojë nga shitësi dorëzimin e mallit menjëherë që nga kontrata momentale, pas kalimit të afatit kontraktues ose pas përmbushjes së kushtit, kemi të bëjmë me kontratë të përhershme. *Detyrimet e Blerësit*, detyrimi kryesor i blerësit në këtë rast është që të paguaj në rregull *preciumin*

² Për shembull: 100-mijë as është çmimi i shitjes së shtëpisë, e dinë palët dhe personi i tretë, çmimi të jetë i drejtë (Justum) – çmimi do të jetë i drejtë nëse është në harmoni me çmimin mesatar të tregut për llojin e mallit mesatar që shitet. E drejta romake ndalon *Lezio Enormis*- dëmtimin mbi gjysmën, nuk lejohet kontraktimi çmimit nën gjysmën e vlerës së mallit që e hasim në treg, p.sh. malli kushton në treg 10mijë as, palët kanë të drejtë që të kontraktojnë çmimin në shumën minimale prej 5mijë as, nëse kontraktojnë nën këtë vlerë do të hasim ne ndalesën e institutit juridik *Lezio Enormis* ligjëdhënësi me këtë institute mbron shitësin në momentet e krizës së tij financiare. Shfaqja e *lezio-enormis* në rast konkret shkakton nulitetin relativ të kontratës.

çmimin, menjëherë në tërësi ose në këste për një periudhë kohore të përcaktuar me kalendar. Meqë paraja është send i zëvendësueshëm mund të ndahet në *pro-paterata* në pjesë. Blerësi ka si detyrim që në kohën dhe vendin e kontraktuar shitësit t'i siguroj kushte teknike që shitësi ta plotësoj në rregull detyrimin e tij, për shembull, të jetë në kohë dhe vendin e caktuar i pranishëm, të siguroj depo për depozitimin e mallit, në të kundërtën rrezikon shfaqjen e vonesës së debitorit dhe shpagimin e dëmit *reparacio dom*.³

2. Roli i së drejtës romake apo *Ius romanussi* sfond historik

E drejta Romake apo *Ius romanus* siç njihet ndryshe në Perandorinë romake nuk u ndal me kaq, por nevoja e komunikimit juridik dhe ekonomik kërkonin edhe shtigje të reja të mëtejshme nga kërkesa që obligatat ose detyrimet mund të krijoheshin vetëm me anë të marrëveshjeve të lidhura me shkrim, sepse çdo gjë shkruhet mund të mbrohet më lehtë në këndvështrimin juridik dhe atë procedural.⁴ Duke u mbështetur edhe në legjislacionin bashkëkohor të Republikës së Maqedonisë, mund të themi se e drejta *private- apo Ius privatum* përfshinë të drejtat personale, të drejtat sendore dhe ato procedurale. Shikuar në këtë prizëm, të drejtën private dhe kontratat në shtetin tonë në përgjithësi janë të mbrojtura me ligjet e vendit dhe ato ndërkombëtare kanë karakter konsensual, që nënkupton se askush nuk mund të detyrojë dikë për të bërë marrëveshje kontraktuale pa vullnetin e lirë të palëve. Shikuar në këtë prizëm, mund të themi se në Republikën e Maqedonisë dhe legjislacionin e saj praktikohen kontratat konsensuale. Ndërsa kur bëhet fjalë për kontratat reale mund të konstatojmë se këto lloj kontratash më tepër janë shfaqur nëpër sistemet bankare, ku një pjesë e qytetarëve kanë detyrime kreditore, dhe si garanci bankare aplikojnë vënien e patundshmërive në hipotekë.⁵

³ Bashkim Dr. Selmani “E drejta romake dhe ndikimi në sistemet e së drejtës bashkëkohore”, f. 506-519. Universiteti Shtetëror i Tetovës-Tetovë, 2013.

⁴ Bashkim Dr. Selmani “E DREJTA ROMAKE dhe ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore”, f. 467-493. Botues: Universiteti Shtetëror i Tetovës. Tetovë, 2013.

⁵ Endru Borkovski & Pol du Plesis “Tekst i së drejtës romake”, f. 4-11. Botimi i III-të. Shtëpia Botuese: Prosvetno dello Ad, Shkup, 2009.

3. Shfaqja e kontratave në sistemin e së drejtës bashkëkohore bankare

Kontratat romake dhe ndikimi i tyre në sistemin së drejtës nacionale dhe ndërkombëtare, ka për qëllimin kryesor se cilat janë këto faktorë që ndikojnë në lidhjen e kontratave reale siç janë; *hipoteka, depozitat, pengu, pengu i dorës, huaja, hua-përdorja* si dhe detyrimet që burojnë nga këto kontraktime mes palëve në të drejtën private të Sistemit të së Drejtës në Republikën Maqedonisë atë ndërkombëtar dhe të drejtës ndërkombëtare private evropiane. Shikuar në këtë prizëm, këtë punim shkencor ku bëhet fjalë për kontratat reale mund të konstatojmë se këto lloj kontratash më tepër janë shfaqur nëpër sistemet bankare, ku një pjesë e qytetarëve kanë detyrime kreditore, dhe si garanci bankare aplikojnë vënien e patundshmërive në hipotekë. Kemi për qëllim të konstatojmë gjendjen faktike se si qëndron pozita e palëve kontraktuale në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar për hulumtimin e të drejtave reale mes palëve kontraktuese dhe burimet ligjore që rregullojnë të drejtën kontraktuale në lëminë e së drejtës private. Në këtë temë të masterit do të mbështetemi edhe në lëndën e të drejtës private dhe atë civile në përgjithësi, sepse po në këto lëndë studimore burojnë edhe të gjitha këndvështrimet e të drejtës kontraktuale që nga kohërat më të lashta dhe deri në ditët e sotme, apo atë të shoqërisë bashkëkohore në përgjithësi që pikërisht ka ndikuar e drejta romake që edhe sot e kësaj dite po e përdorin sistemet më të mëdha të së drejtës bashkëkohore në këtë pikëpamje: Roli i subjekteve detyrimore në një marrëdhënie juridike të detyrimit, si dhe të drejtat juridiko-civile bazë kontrakteve reale huaja-mutuum, huapërdorja-comomdatum, pengu-pignus dhe pozicioni i palëve në nivel nacional, ndërkombëtar dhe të drejtën ndërkombëtare private të BE-së. Kontratat reale dhe e drejta kontraktuale do të trajtohen si pjesë e posaçme e të drejtës civile nacionale, ndërkombëtar dhe të drejtën ndërkombëtare private të BE-së. E drejta e detyrimeve si edhe e drejta juridiko-civile me karakter hipotekar dhe roli i palëve në pozitën juridiko-civile nacionale, ndërkombëtar dhe të drejtën ndërkombëtare private të BE-së.⁶

⁶ Bashkim Dr. Selmani “E DREJTA ROMAKE dhe ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore”, f. 467-493. Botues: Universiteti Shtetëror i Tetovës. Tetovë, 2013.

4. Kalimi nga kontrata të ngjashme me konsumatorin në zhvillimin e së drejtës konsumatore në botë

Mbrojtja e konsumatorit i ka rrënjët e saj në jetën e përditshme të njerëzve. Koncepti i të qenit konsumator gjen shprehjen e tij që në lash-tësi, në kohën e njerëzve që jetonin nëpër shpella. Njerëzit shkëmbenin mall me mall në funksion të plotësimit të kënaqësive të tyre ose të plotësimit të nevojave për ushqim. Në origjinën e saj, forma më antike e shitblerjes konsiston në këmbimin ose ndërrimin e disa sendeve me të tjerët. Sipas juristit romak Paulus: “Shitblerja e ka origjinën tek ndërrimi këmbimi i sendeve. Kontrata e shitjes ose siç quhej në atë kohë kontrata e shitblerjes pasqyron fazat e parë të lindjes së marrëdhënies juridike civile, ku njëra nga palët ishte më e dobët se tjetra. Në mungesë të përputhjes së interesave të këmbimit mall-mall, njerëzit krijuan një lloj materiali të vlefshëm që do të shërbente si ekuivalencë malli. Në këtë mënyrë lindi koncepti i çmimit. E drejta romake rregullonte në detaje elementet e kësaj kontrate si: ekzistenca e konsensusit, objektin e kontratës, çmimin, të drejtat dhe detyrimet e palëve si dhe paditë me të cilët mund të mbroheshin ato. Ajo që spikat është lidhja e çmimit me cilësitë e sendit.

Pomponiusi theksonte se është e logjikshme për vetë natyrën e shitblerjes që kontraktuesit të mashtrojnë reciprokisht mbi çmimin e sendit. Nëse çmimi nuk ishte i drejtë, pra, nuk i korrespondonte vlerës së vërtetë të *merx-it* në momentin e kontratës, e drejta klasike sanksionoi me mjetet juridike, në formën e sanksionit mashtrimin e njërës palë në dëm të tjetrës, si shitje nën çmimin e bërë në mënyrë të ndërgjegjshme nga shitësi dhe atë mbi çmimin, e pranuar në mënyrë të ndërgjegjshme nga blerësi. Një tjetër fazë e së drejtës romake që na lidh me aspekte të ngjashme me konceptin e konsumatorit, pikërisht me kredinë konsumatore, është mandati për dhënie parash. Ky mandat konsiston në urdhërimin që prokurëdhënësi i jep prokurëmarrësit t’i japë para një të treti ose të hapë kredi për një të tretë. Në këtë rast krijohet një hua midis prokurëmarrësit dhe personit të tretë. Këto pasqyrojnë momentet e para të juristëve që synonin të rregullonin dhe të vendosnin parimin e barazisë ndërmjet palëve. Blerësi ishte pala më e dobët ekonomikisht dhe më pak e mbrojtur juridikisht. Mbi të ekzistonte gjithmonë rreziku i të rënit pre e mashtrimeve të shitësit në lidhje me çmimin, cilësinë e sendeve ose më të metat e tyre. Në kushtet ku parimi i autonomisë së vullnetit nuk kishte marrë ende formën dhe strukturën e tij, rregullimet ligjore të sanksionuara nga e drejta romake

përbëjnë embrionin e parë të vendosjes së një ekuilibri në treg, një ekuilibër që anon nga mbrojtja e palës më të dobët, blerësit.⁷

5. Shoqëria e konsumit, në formën që ka marrë sot

Shoqëria e konsumit, në formën që ka marrë sot, e ka origjinën e saj në fundin e shekullit XIX-të dhe fillimi i shekullit XX-të në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kongresi Amerikan bëri histori me ligjin e parë të vitit 1872 që përfshinte brenda qëllimit të tij mbrojtjen e konsumatori, ku mashtrimi me mallrat u konsiderua i dënueshëm penalisht. Ky ligj, si një rudiment i kohës, nuk bëri asgjë për të parandaluar reklamën mashtruese apo produktet e pasigurta dhe të rrezikshme të cilat përdorshin nga konsumatorët e painformuar. Akti Sherman Antitrust, i vitit 1890 shënon një moment të ri në zhvillimit e mbrojtjes së konsumatorit. Ky akt përbën mjetin e parë të ndërmarr nga Kongresi Amerikan për të ndaluar monopolet abuzive, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtat e konsumatorëve. Ky ligj federal nuk adresonte në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen e konsumatorit, veçanërisht në lidhje me cilësinë e produkteve. Përveç aspekteve të vogla legjislative në nivel shtetëror, fillimi i shekullit të XX-të shënoi ringjalljen e lëvizjes për mbrojtjen e konsumatorit. Shtysa ishte libri “Xhungla” i Upton Sinclair, ku autori shprehte indinjatën e tij për industrinë e paketimit të mishit në Çikago. Pasi verifikoi këto të dhëna në lidhje me kushtet e tmerrshme higjienike-sanitare të mishit me të cilin ushqeheshin konsumatorët amerikanë, në 1906 Kongresi Amerikan miratoi Aktin Mbi Ushqimin dhe Ilaçet e Sigurta, i cili synonte të ndalonte shitësit nga shitja e ushqimeve të falsifikuara dhe i detyronte ato të vendosnin të dhëna të sakta në etiketa mbi produkte. Së bashku me Aktin Mbi Inspektimin e Mishit, qeveria amerikane plotësoi një kornizë ligjore, e cila i lejonte ndjekjen penalisht të çdo personi që cenonte cilësinë e ushqimit dhe të ilaçeve të përdorura nga konsumatorët.

Në këtë mënyrë konstatojmë përpjekjet a para reale që synojnë të mbrojnë të drejtat e konsumatorëve, pikërisht të drejtën e shëndetit dhe vënies në treg të produkteve të sigurta.⁸Në periudhën pas Luftës së Dytë

⁷ Mandro, Arta “E drejta romake”, Tiranë, 2001, f. 262. 11,po aty, f. 262 – 274. Olldashi, Enkeleda “E drejta romake”, Mediaprint, Botim i parë, f. 183-191. 12 Olldashi, Enkeleda, vep. e cit. f. 187. 13 Mandro, Arta vep. e cit. f. 289. 13.

⁸ Bashkim Dr. Selmani “E DREJTA ROMAKE dhe ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore“ f. 467-493. Botues: Universiteti Shtetëror i Tetovës. Tetovë, 2013.

Botërore, në Amerikë ishte krijuar përshtypja se tregjet kishin karakter të papërcaktuar. Balanca e pushtetit ndërmjet konsumatorëve dhe tregtarëve ishte në favor të këtyre të fundit. Mbrojtja asokohe u konsiderua e papërshtatshme. Rritja e mbrojtjes ligjore në favor të konsumatorëve u vlerësua si e vetmja mënyrë për të rregulluar balancën e fuqive nëpër tregje. Në mesin e shekullit të njëzetë, Ralph Nader dhe John F. Kennedy janë dy figura të rëndësishme në lëvizjen për mbrojtjen e konsumatorit. Në një fjalim historik në vitin 1962, Kennedy ishte i pari që afirmoi të drejtat themelore të konsumatorit siç janë dhe në ditët e sotme.

Presidenti Kennedy, në mesazhin që i dërgoi Kongresit Amerikan u shpreh se: “Përcaktimi i termit konsumator përfshin një ekonomistë dhe studiues i ndryshëm që ka pohuar se monopolet e parregulluara që synojnë të dëmtojnë ekonominë: duke vendosur çmime më të larta; duke ofruar mallra dhe shërbime të një cilësie inferiore; ndikojnë negativisht në zhvillimin e risive krahasuar me një situatë konkurruese. Nëse konsumatorëve u ofrohen produkte jociësore, nëse çmimet janë shumë të larta, nëse ilaçet janë të pasigurta, nëse konsumatori nuk është një gjendje që të bëjë zgjedhjen më të mirë për shkak të mungesës së informacionit, atëherë dollari nuk ka vlerë, shëndeti dhe siguria e konsumatorit janë të cenuara dhe interesi kombëtar dëmtohet.”⁹

Të gjitha ligjet e mëparshme federale ishin të papërshtatshme dhe publiku i gjerë nuk kishte fare informacion mbi të drejtat e tyre. Konsumatorët jetonin në një mjedis me probleme të mëdha si: shteti konfiskonte dhe merrte në posedim pasuri të tyre përpara përfundimit të gjykimit, ekzistenca e diskriminimit në marrjen e kredive, praktikat abuzive në mbledhjen e kredive të dhëna, norma të larta interesi, mashtrime apo pamundësi mbrojtje e konsumatorit nga praktikat e padrejta të kreditorëve. Ligji “Mbi modelet e praktikave të padrejta tregtare dhe mbrojtjen e konsumatorit”, i amenduar në vitin 1970 trajtonte tre modele praktikash tregtare të cilit ishin të padrejta, agresive ose

⁹ Presidenti Kennedy riafirmoi katër të drejta bazë të konsumatorëve: të drejtën për siguri, të drejtën për t’u informuar, të drejtën për të zgjedhur dhe të drejtën për t’u dëgjuar. Një moment tjetër shumë i rëndësishëm në lëvizjen për mbrojtjen e konsumatorit është botimi i librit “I pasigurt në çdo shpejtësi” i Ralph Nader, në vitin 1967. Ky libër shënon përpjekjen e parë nga një qytetar në ushtrimin e së drejtave të tij si konsumator kundër korporatave të mëdha “peshkaqenë”. Akti Mbi Kreditimin, i vitit 1968, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është akti i parë ligjor që rregullon industrinë e shërbimeve financiare të konsumatorëve, duke u njohur atyre disa të drejta.

mashtuese. Ky ligj parashikonte lindjen e përgjegjësisë civile për ato subjekte që e cenonin atë. Shtetet jashtë kontinentit amerikan i kanë miratuar shumë vonë ligjet për mbrojtjen e konsumatorit. Në Indi, qeveria ka miratuar Aktin për Mbrojtjen e Konsumatorit në vitin 1986. Sipas disa studiuesve, ky ligj është një përpjekje mediokre për të mbrojtur konsumatorët. Ai nuk i shtrin efektet e tij në fusha si: siguria e produkteve, etiketimi i tyre, zbatimi i ligjit dhe ndëshkimi i shkelësve të tij. Në ditët e sotme tregtarët atje vazhdojnë ende të tregtojnë produkte të pasigurta dhe shteti të mos ndërmarrë asnjë masë. Debatimi për mbrojtjen e konsumatorëve, në Evropë, e ka kulmin e tij rreth viteve 1970-1980, ku studiues të së drejtës kanë teza të ndryshme në lidhje me mënyrën se si mund të ofrohet më mirë kjo mbrojtje. Në Samitin e Parisit, në tetor të vitit 1972, Shtetet Anëtare shfaqën vullnetin e tyre për të zgjeruar ndërhyrjen e Komunitetit përtej çështjeve ekonomike, në sferën shoqërore.

Krërët kryesore të shteteve dhe të qeverive pranuan miratimin e një programi për mbrojtjen e konsumatorëve.¹⁰ Vetë presidenti John F. Kennedy në fjalimin e tij është shprehur se: “Zakonisht, konsumatori nuk e di se sa po paguan ai për kredinë e marrë...”¹¹ Ndër rekomandimet që ai dha në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve ishin ndërmarrja e një sërë hapash ligjore dhe administrative në lidhje me shërbimet financiare, veçanërisht për kredidhënien, ku konsumatorët nuk kishin fare informacion në lidhje me shumatat që ato paguanin pas marrjes së kredisë, me ndryshimin e interesit ose normave shumë të larta të tij. *Programi i parë i plotë* për Komunitetin Evropian, për mbrojtjen e konsumatorëve, daton në vitin 1975, i cili parashikoi një plan veprimi dhe afirmoi pesë të drejta themelore për konsumatorin: mbrojtja e shëndetit dhe e sigurisë, mbrojtja e interesit ekonomik, e drejta e informimit dhe e edukimit, e drejta e ankimit dhe e drejta e përfaqësimit. Programi i parë përcaktonte se: “Konsumatori nuk do të shihet më thjesht si një blerës ose përdorues i mallrave ose shërbimeve për qëllime personale, familjare ose të grupit, por gjithashtu si një person që synon të ndikojë në shoqëri, në sajë të të qenit konsumator në mënyrë direkte ose indirekte.” *Programi i dytë* u miratua në vitin 1981, i cili në raport me

¹⁰Kennedy, John F. “Special message to the Congresson Protecting the Consumer Interest”, 15 March 1962. Fjalimi i plotë gjendet në: <http://www.presidency.ucsb.edu/ws/>

¹¹John F. Kennedy, Special message to the Congresson Protecting the Consumer Interest, 15 March 1962.

programin e mëparshëm shtoi një të drejtë tjetër të rëndësishme të konsumatorëve: të drejtën për dëmshpërblim. Ky program u përqendrua kryesisht në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në lidhje me çmimin dhe cilësinë e produkteve dhe shërbimeve, si dhe në krijimin e një klime të qetë dialogu dhe bisedimesh ndërmjet konsumatorëve ose përfaqësuesve të tyre me tregtarët apo furnizuesit. Të dy këto programe përfshiheshin në atë që konsiderohej “e drejtë e butë”, të cilët në momentin që u hartuan luajtën një rol të madh në ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e Shteteve Anëtare. Programi i tretë u zhvillua me Rezolutën e Këshillit të Komunitetit Evropian me datë 06 maj 1986, e cila u përthith nga Akti Unik Evropian, i vitit 1987. Akti Unik Evropian riafirmoi se në funksion të përmbushjes së të ashtuquajturave “nevoja të mëdha”, sipas ish-nenit 100 A të Traktatit të Komunitetit Ekonomik Evropian.

Shtetet Anëtare duhet të provojnë se legjislacionet e tyre kombëtare nuk janë diskriminuese ose nuk përmbajnë dispozita kufizuese në lidhje me tregtinë e lirë. “Nevojat e mëdha” përfshinin çështje të tilla si: shëndeti, siguria, mjedisi dhe mbrojtja e konsumatorit. Komisioni, në fillim të viteve 1990 deklaronte se: “Duhet të sigurohet promovimi dhe mbrojtja e interesave të konsumatorëve evropianë. Në përputhje me Rezolutën e Këshillit, në fund të nëntorit, Komisioni do të hartojë skema që synojnë rritjen e nivelit të besimit të konsumatorëve, duke siguruar informacion të plotë, sistematik dhe më efektive, duke rritur transparencën e tregut dhe duke përmirësuar sigurinë e produkteve dhe shërbimeve, objekte të tregut të përbashkët”. Akti i parë në kuadër të legjislacionit komunitar që i kushton një rregullim specifik mbrojtjes së konsumatorëve, duke angazhuar Komunitetin në një nivel më të lartë mbrojtjeje për konsumatorët është Traktati i Maastrichtit. Ai parashikon detyrimin e Komunitetin për të nxitur dhe siguruar një nivel më të lartë të mbrojtjes sociale dhe të kontribuojë në forcimin e mbrojtjes së konsumatorëve. Për herë të parë, një akt komunitar i kushtoi rëndësi kësaj sferë të veprimit të Komunitetit.

Komisioni Evropian deklaroi nën titullin “Parimi i subsidiaritetit” se: “Politikat në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit duhet të menaxhohen në mënyrë efektive nga Shtetet Anëtare mbi bazën e vazhdueshmërisë së menaxhimit dhe kontrollit të sigurisë, informimit dhe dëmshpërblimit, në përputhje me nevojat lokale të çdo instance. Marrja e të tilla masave në nivel komunitar në mënyrë të vazhdueshme nuk është reale”. Traktati i Amsterdimit riafirmoi kompetencat e Komisionit në fushën e

mbrojtjes së konsumatorëve, me synimin sigurimin e një niveli më të lartë mbrojtjeje duke marrë në konsideratë ndryshimet sociale dhe faktet shkencore. Neni 129a u ndryshua, në nenin 153/2 dhe ai parashikoi se: “Me qëllim promovimin e interesave të konsumatorëve dhe sigurimin e një niveli më të lartë të mbrojtjes së konsumatorëve, Komuniteti duhet të kontribuojë në mbrojtjen e shëndetit, sigurisë dhe interesave ekonomikë të konsumatorëve, gjithashtu duhet të promovojë të drejtën e tyre për informim, edukim dhe të drejtën për t’u organizuar me qëllim mbrojtjen e interesave të tyre.”¹² Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian ripohoi parimin e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve. Ky akti përcaktoi detyrimin e Bashkimit që në politikat dhe aktivitetet e tij të përfshihet mbrojtja e konsumatorit, duke ngarkuar Komisionin me detyrën për të kontrolluar përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare me legjislacionin komunitar në këtë sferë. Mbrojtja e konsumatorit gjendet dhe në fusha të tjera si: agrikultura, konkurrenca, ndihmat e dhëna nga shteti. Ish-neni 153/2, aktualisht neni 169, lë të nënkuptuar lidhjen ndërmjet tregut të brendshëm dhe mbrojtjes së konsumatorëve.

6. Të drejtat e konsumatorit janë ngushtësisht të lidhura me konceptin dhe zhvillimin e së drejtës kontraktore

Të drejtat e konsumatorit janë ngushtësisht të lidhura me konceptin dhe zhvillimin e së drejtës kontraktore. Kontratat konsumatore janë parë si e vetmja fushë veprimi ku Bashkimi mund të ndërhyjë për të unifikuar mënyrën e tyre të rregullimit, duke realizuar të ashtuquajturin Kodin Civil Evropian. Interpretimi dhe zbatimi i katër lirive themelore, veçanërisht zhvillimi i parimit të proporcionalitetit, shpesh zvogëlon hapësirën publike të bërjes së ligjeve duke stimuluar iniciativat private në këtë fushë, veçanërisht në sferën e konkurrencës. Rregullimet me karakter privat pas sjellin shkelje të mundshme të lirive, sidomos kur cenojnë tregtinë e lirë ose kur ajo është në shërbim të interesit publik, si për shembull: detyrimi për të implementuar kërkesat që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit.

¹² Traktati i Lisbonës bëri një rinumërim të neneve, duke e parashikuar nenin 153 (2) në nenin 6a28. Ky traktat parashikoi ndarjen e kompetencave ndërmjet Bashkimit dhe Shteteve Anëtare në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, duke riafirmuar diskrecionalitetin e Shteteve Anëtare në masat dhe mjetet ligjore dhe administrative, aspekt të cilin e konstatojmë gjatë zhvillimit të kësaj teze.

Për të promovuar interesat e konsumatorëve dhe për të siguruar një nivel të mbrojtjes së konsumatorëve, Bashkimi kontribuon në mbrojtjen e shëndetit, sigurisë dhe interesave ekonomike të konsumatorëve, si dhe në promovimin e së drejtës për informim, edukim dhe organizim, në mënyrë që të mbrojnë interesat e tyre. Bashkimi kontribuon në arritjen e objektivave të përmendura në paragrafin e 1 përmasave të miratuara në zbatim të nenit 114 në kuadër të realizimit të tregut të brendshëm; masave të cilat mbështesin, plotësojnë dhe vëzhgojnë politikën që ndjekin Shtetet Anëtare...” ose mbrojtjen e mjedisit.

Ndërsa Ligji *Mbi Konkurrencën* ndikon në mënyrë indirekte në mirëqenien e konsumatorëve, rregulloret me karakter privat sipas parashikimeve të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian i vendosin kufij tregut të brendshëm dhe ndikojnë në zgjedhjet e konsumatorëve. Rregulloret me karakter privat dispiplinojnë kontratat biznes dhe biznes konsumator. Studiuesit e së drejtës analizojnë ndikimin e këtyre akteve në procesin e së drejtës kontraktore evropiane duke shqyrtuar praktikën tregtare, praktikën doganore, instrumentet e reja si: kodi i sjelljes së tregtarëve, kontratat me karakter rregullues dhe udhëzues të ndryshëm. Që në fazat fillestare ligjvënësi evropian tentoi të ofrojë praktika dhe rregullim të njëjtë në kuadër të së drejtës kontraktore evropiane, tentativa të cilat dështuan ekzistencën e një Kodi Civil Evropian. Uniformizimi haset sot në disa kontrata standarde të hartuara nga shoqëri tregtare të fuqishme, kontrata të cilat duhet të përthithen nga legjislacionet kombëtare të Shteteve Anëtare.

7. Standardizimi gjendet midis harmonizimit dhe fragmentimit

Kështu, ai luan një rol të rëndësishëm në formësimin dhe strukturimin e një tregu të përbashkët të integruar duke ndikuar në integrimin ligjor evropian.¹³ Mbështetur në Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, tregu i brendshëm është një hapësirë e lirë e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, si dhe synon lirinë e zgjedhjes. Kjo Direktivë parashikon rregulla të përbashkëta për disa aspekte të kontratave në largësi dhe të kontratave të lidhura jashtë qendrave të tregtimit. Ajo synon të promovojë një treg të brendshëm të lirë duke ofruar një nivel më të lartë mbrojtjeje për konsumatorin, rritjen e konkurrencës dhe

¹³ Harmonizimi i së drejtës kontraktore u limitua në Direktivën 2011/83/UE, datë 25/10/2011 “Mbi të drejtat e konsumatorëve”.

respektimin e parimit të subsidiaritetit. Megjithëse Direktiva quhet Direktiva “Mbi të drejtat e konsumatorëve” fusha e zbatimit të saj është shumë e kufizuar. Bashkimi ka ende shumë për të bërë në funksion të arritjes së një niveli të lartë të mbrojtjes së konsumatorit, në kuadër dhe të harmonizimit të legjislacioneve kombëtare me atë të Bashkimit. Në çështjet në vazhdim do të vërehet që Shtetet Anëtare nuk i transpozojnë Direktivat e Bashkimit Evropian në të njëjtën mënyrë. Shtetet Anëtare e konsiderojnë fushën e mbrojtjes së konsumatorëve si një sferë që përfshihet ende brenda konceptit të sovranitetit të tyre kombëtar. Për shkak se ato nuk ishin të përgatitura për të unifikuar këtë sferë veprimi, duke ia kaluar kompetencat e tyre institucioneve të Bashkimit, projekti për një Kod Civil Evropian dështoi. Parimi i subsidiaritetit synon të përcaktojë nivelin më të përshtatshëm të ndërhyrjes së Bashkimit Evropian në fushat me kompetenca të përbashkëta ndërmjet tij dhe Shteteve Anëtare. Veprimi mund të jetë në nivel evropian, kombëtar ose vendor. Në çdo rast, Bashkimi mund të ndërhyjë vetëm nëse është në gjendje të veprojë në mënyrë më efektive se Shtetet Anëtare. Protokollin për zbatimin e parimit të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit parashikon tri kushte që konfirmojnë ose mohojnë mundësinë e veprimit në nivel evropian: veprimi përfshin aspekte mbikombëtare që nuk mund të zgjidhen nga Shtetet Anëtare, veprimi nga Shtetet Anëtare ose mungesa e veprimit nga ana e tyre është në kundërshtim me dispozitat e Traktatit? Veprimi në nivel evropian reflekton avantazhe të qarta? Parimi i subsidiaritetit synon të afrojë Bashkimin me qytetarët e tij. Ky parim nuk do të thotë që duhet të merret gjithmonë veprimi në nivelin më afër qytetarit. Mbrojtja e konsumatorit përfshin në ato fusha ku konkurrojnë kompetencat e Bashkimit me ato të Shteteve Anëtare. Parimi i subsidiaritetit i lejon Bashkimin që në një fushë të tillë të mund të veprojë vetë, nëse objektivat për këtë fushë nuk arrihen në mënyrë të konsiderueshme nga Shtetet Anëtare, në nivel kombëtar ose vendor, për këtë arsye gjykohen që rezultati mund të arrihet më mirë në nivel Bashkimi.¹⁴

Një rol të rëndësishëm në këtë fushë ka luajtur Gjykata Evropiane e Drejtësisë, e cila në ushtrimin e kompetencave të saj, veçanërisht në rastin e çështjeve paragjykimore, ka analizuar dhe interpretuar më tej

¹⁴ Detyrimet kontraktuale me karakter ndërkombëtar po përballen me shumë sfida të cilat do t'i trajtojmë në këtë punim shkencor në këndvështrimin e së drejtës ndërkombëtare private dhe pengesat që po paraqiten në këndvështrimin e legjislacioneve ndërmjet shteteve.

një numër shumë të madh institutesh, në funksion të arritjes së një niveli sa më të lartë mbrojtjeje për konsumatorin.¹⁵

8. Liria e rregullimit të marrëdhënieve kontraktuale ka mundësuar krijimin e kontratave ndërkombëtare

Vlerësimi i karakteristikave të veçanta të të drejtave të detyrimeve kontraktuale si dhe pozita e gjendjes reale në mbrojtjen gjyqësore në rast mospëmbushjeje të detyrimeve mes palëve kontraktuale në të drejtën reale, ndërkombëtare. Roli i subjekteve detyrimore në një marrëdhënie juridike të detyrimit, si dhe të drejtat juridiko-civile në një kontest gjyqësor me karakter ndërkombëtar. Pasqyrimi me anë të qasjes analitike dhe studimit shkencor që do të parashihen në rolin e kontratave reale *reals-contratct* si dhe roli i pavlefshmërisë dhe pozita e pasojave të dallimit *persona që mund të veprojnë edhe kur kontrata është e ndaluar* në nivel-nacionale, ndërkombëtar dhe të drejtën ndërkombëtare private të BE-së.

Conclusion

Regulations freedom of the contractual relations has enabled the creation of numerous contracts and diverse in point of view of historical and legal in many major systems of law in the past and will also be so valuable in the future to the system of private law and property law in general. Using the so-called "examples of good practice", they are also reflected some of the new recommendations of the Council of Europe dealing with private international law itself which are included the actual contracts, civil legal proceedings for contract and procedure law that really is based this scientific paper.

Challenges of private international law should be seen in the spirit of harmonization of contract law that can come to inconsistency at European level and wider as a barrier which restricts fundamental legal private rights of the citizens, as a rights who belongs to the usefulness of the person and consists of three parts as; Personal relations between citizens, property relations with persons of authority as titular property and procedural law governing the protection of individual rights and property of personal character that in practice face more difficulties in private international law.¹⁶

¹⁵ Weatherill, Stephen, vep. e cit. f. 20. 27, për më tepër lexo Traktati i Amsterdami, 2 Tetor 1997, në: <http://www.eurotreaties.com/amsterdamtreaty.pdf> 28 Traktati i Lisbonës, 13 Dhjetor 2007, OJ C 306 mund të gjendet online në: http://bookshop.europa.eu/isbin/INTERSHOP.enfinity/WFS/EU-Bookshop-Site/en_GB/-/EUR/ViewPublicationStart?PublicationKey=FXAC07306 29

¹⁶Ky punim shkencor pat për qëllim të hulumtoj dhe të konstatojë se a mundet të krijohen shqetësime në zbrazëtirat juridike nacionale apo probleme eventuale si rezultat të dallimeve në të drejtën kontraktualendërkombëtare të vendeve anëtare të

Bibliografia

1. Alpa, Branca, European Community Result and the Codification of "Private Law", Eur. Rev of Priv. Law, 2000.
2. Bashkim Dr. Selmani "E DREJTA ROMAKE dhe ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore" Botues: Universiteti Shtetëror i Tetovës. Tetovë, 2013.
3. Tutulani-Semini, Mariana "E drejta e detyrimeve dhe e kontratave pjesa e përgjithshme dhe e posaçme". Tiranë: Skanderbeg Books, 2006.
4. Mandro Dr. Arta "E drejta romake" Emal, Tiranë, 2011.
5. Nerxhivane Dr. Dauti "E Drejta e Detyrimeve" Prishtinë 2004
6. Endru Borkovski & Pol du Plesis "Tekst i së drejtës romake " - Botimi i III-të. Shtëpia Botuese: Prosvetno dello Ad, Shkup, 2009.
7. Nuni, Ardian. Mustafa, Ilir. E drejta e detyrimeve Vol. I e II. Tiranë: SHBLU, 2008.
8. Galgano, Francesco. E Drejta private. Tiranë: Luarasi, 2006.
9. Mariana Dr. Tutlani-Semini "E drejta e detyrimeve dhe e kontratave" tiranë, 2006
10. M. Semini; "E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave" volumi I dhe II. Shtëpia botuese "Afërdita, Tirane 1988, Shtëpia botuese " Scanderbeg book" Tiranë 2007.
11. Nazmi Bicoku; "E Drejta e Trashëgimisë ne Republikën e Shqipërisë" Tiranë 1998
12. Avni Shehu; "Pronësia" Shtëpia botuese e Librit Universitar, Tirane 1998
13. Kodi Civil Shqiptar; Shtëpia botuese "ALBAL", Tirane 1997 Kodi Civil i vitit 1929 Kodi Civil i vitit 1981.
14. Pasuritë e paluajtshme" Vol.1 dhe II, Shtëpia botuese " ALBAL" Tirane 1996

Bashkimit Evropian dhe vendeve jo anëtare të BE-së, dhe në rast se ekzistojnë problemet dhe vështirësitë juridike apo shqetësime reale në këtë lëmi, a duhet funksionimi i brendshëm tregtar dhe ai juridik, me interpretimin e tyre të vështirësojnë kontraktim mes palëve me rastin e lidhjes së kontratës me karakter ndërkombëtar ose ndërsh-tetëror në të drejtën detyrimore me rastin e lidhjes së kontratës, interpretimin, të drejtat dhe detyrimet ose çështje të tjera juridike që kanë të bëjnë me implementimin e së drejtës private ndërkombëtare dhe të drejtës private ndërkombëtareevropiane.

15. Mehedi J.Hetemi; Detyrimet dhe kontratat”, Shtëpia botuese “Luarasi” 1998 “Obligimet dhe kontratat e përgjithshme”, Shtëpia botuese “Luarasi” Botuar sipas origjinalit 1932.

16. Ligji Nr.10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”.

17. Ligji Nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor”, Ligji për procedurën kontestimore,

18. Ligji për procedurë Përmbarimore,

19. Aliqivadh Lamani, “Procedura Civile e Shqipërisë”, 1962,

20. Maho, B. (2011). “Profesionet e lira” (Cikël leksionesh). Tirane: UET Press.

21. Malindi, Y. Ceco, S, Hasani, S. (1986). “E Drejta Procedurale Civile RPSSH”. Tirane: Shtëpia botuese e Librit Universitar.

22. Mariana Semini; “E Drejtë Civile. Pjesa e Përgjithshme. Subjektet” Fakulteti i Drejtësisë “Justicia” Tirane 2004

23. Valentina Kondili “E Drejte e Pronësisë” Tiranë, 2007

24. Ardian Nuni “E Drejte e Pronësisë” Tiran,

25. J. Latifi “ E Drejte Civile” Tirane

26. Valentina Kondili “E Drejte Civile. Pjesa e përgjithshme” Tiranë, 2007

27. Bashkim Dr Selmani & Bekim Mr. Rexhepi “E drejta familjare dhe trashëgimore (romake) dhe ndikmi isaj në të drejtën bashkëkohore shqiptare”-Ferizaj, 2014.

Kodet civile të disa shteteve

- ✓ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
- ✓ Kodi i Procedurës civile të Republikës së Shqipërisë
- ✓ Kodi civil i Republikës së Turqisë
- ✓ Kodi Procedurës civile të Republikës së Turqisë
- ✓ Kodi Civil i Republikës i Austrisë
- ✓ Kodi Civil i Gjermanisë
- ✓ Kodi civile i Kroacisë
- ✓ Kodi civile i Sllovenisë
- ✓ Kodi Civil i Maqedonisë